



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. Prot

Tiranë më, _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI
“BLERJE KANCELARI” PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2024**

OBJEKTI PROCEDURËS: “Blerje Kancelari”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): FPP)

Stilolapsa- 30192124-6

Kapese letrash- 30197220-4

Zarfa - 30199230-1

Furnizime dhe pajisje të ndryshme zyre- 30190000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 ,628,611 (njemilion e gjashtëqind e njezet e tetemije e gjashtëqind e njembdhjete) **leke pa TVSH** me burim financimi projekt-buxhetin afatmesem 3 vjecar 2024-2026.

Bazuar në Vendimin Përfundimtar të KPP-së nr. 314/2024 prot datë 28.03.2023, Vendimit të KPP-së Nr.374/2024 datë 18.04.2024 për lejimin e anulimit të procedurës si dhe Vendimit të KPP-së nr. 474/2024 datë 09.05.2024 mbi lejimin e rihedhjes së procedurës nga Autoriteti Kontraktor sipas konstatimeve referuar Vendimit të KPP-së nr. 314/2024 prot datë 28.03.2023, DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i thjeshtuar» ,bazuar në nenin 55 te VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 49 të Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik» me mjete elektronike, me afat **25 ditë nga data e lidhjes se kontrates mbi **sasinë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:****

SASIA E MALLIT DHE SPECIFIKIMET:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Specifikime teknike të mallrave
1	Libër Protokolli 400 fletë	copë	20	Të jetë sipas modelit të përcaktuar për protokoll, me lidhje, jo me pak se 400 fletë. Përmasat 33.6 x 24.5 cm (+/- 2 cm marzh gabimi).
2	Libër Poste	copë	20	Kapak kartoni, me ngjitje, sipas modelit të përcaktuar, fletë e bardhë, minimumi 100 fletë, me rubrika sipas kërkesës së AK-së, me qepje ose me ngjitje, format A4 (+/- 2 cm marzh gabimi)
3	Regjistër themeltar	copë	10	Me përmasa 45x30 cm, me 200 flete
4	Dosje me mekanizëm	copë	500	Dosje me mekanizëm, Formati A4, gjerësia deri në 8 cm, me kuti e plastifikuar
5	Dosje plastike me ngjitese	copë	200	Formati A4, plastike me mbyllje me ngjitje, me llastik, me buton apo/ose ekuivalente.
6	Qese A4 100 flete	pako	500	Pako me 100 qese plastike A4 për konservimin e dokumentave ose vendosjen në dosjet me mekanizëm.
7	Staples” 24/6 + 23/13	kuti	200	Sasia: 100 kuti 24/6 Sasia: 100 kuti 23/13 Sqarim: 1 kuti përmban 1000 tela (staples) Te jenë metalike dhe shumë cilësore.
8	Kapëse aktesh	kuti	200	Kapëse aktesh (metal me veshje plastike) 33mm – Sasia 200 kuti. Të dhëna të tjera: 1 kuti përmban 50 copë
9	Stick”,ngjitës 36gr	copë	50	Stik deri ne 36 gram dhe max 40 gram
10	Stilolapsa blu	copë	1000	Stilolapsa blu,majasferike.
11	Stilolapsa të kuq	copë	10	Stilolapsa të kuq,majasferike
12	Bojë vule	copë	10	Ngjyrë blu
13	Mbajtëse vule	copë	5	Mbajtese vule/tampon vule blu
14	Letër formati A4 80g/m2	Rizma	1999	Leter fotokopje A4 80g/m.- Përmasa 29.7x210, A4.- Lëmueshmëria: 80-130 ml/min.- Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma.- Përdorimi për fotokopje dhe printim.- Lagështia: 3.5-4.5%.- Trashësia: 101-107

				<p>µm.- Dukshmëria:>94%.- Shkëlqimi: 101-115%.- CIE bardhësia: 157-163.- Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.- Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.- Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.- Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.- Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m2 - Të mos jetë e ricikluar. - Me risma 500 fletë secila. Ngjyra e bardhe. Te kete kualitet ne printim dhe te konsumoje sa me pak boje.</p>
15	Makinë kapëse aktesh 23/13	copë	5	E pershtatshme per te kapur min 80- max 90 fletë
16	Gomë fshirëse	copë	50	Cilësi e butë për fshirje
17	Kapëse aktesh nr. 5	kuti	200	Për kapje letrash, nr.5, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
18	Fletë-udhëtimi	bllok	200	Fletë udhëtimi për flotën transport
19	Staple	copë	200	Staples, Përmasa Nr. 10. 24/6, Staples, 200 cope
20	Gërshërë	copë	20	Gërshërë zyre te thjeshta
21	Makinë llogaritëse profesionale	copë	10	Makinë llogaritëse profesionale (16 digit)
22	Mbajtëse kancelarie	copë	30	Mbajtëse kancelarie, me 4 vende me material rrjete ose ekuivalente.
23	Korrektor	copë	100	I bardhë per korigjim
24	Evidenciator	copë	100	Me ngjyra të ndryshme. Evidenciatori shërben për evidentimin e fjalëve dhe paragrafëve të ndryshëm në një shkresë ose shënim në letër
25	Heqëse kapsesh	copë	200	Heqëse kapësesh me përbërje celiku ne forme pince
26	Bllok shënimesh me ngjitje stick notes	copë	600	Letër me ngjitje 75 x 75 mm. me ngjyra të ndryshme. Minimum 100 fletë një paketim.
27	Dosje Personeli	copë	700	Dosje personeli, materiali kartoni, ngjyra gri, me permasat e formatit A4.
28	Dosje me qese	copë	50	Dosje me 60 deri 100 zarfa plastik ku ne kapakun e jashtem te kete xhep per vendosjen e etiketave

29	Kalendar	copë	10	Kalendar i thjeshtë 2024 Përmasat 15x30cm-min Përmasat 20 x 40 cm max
30	Blinder clipps” me madhësi të ndryshme 32,18	copë	1000	a) Përmasa 32 mm Sasia 720 copë b) Përmasa 18 mm Sasia 280 copë (materiali metalik dhe plastikë)
31	Bllok axhende	copë	80	Bllok axhende ditore (imitacion lekure (simil-pelle), përmasat min17x max 24, viti 2024)
32	Vinovil 1000 ml	copë	20	Vinovil 1000 ml (vinovil cilesor)
33	“Staples” 8/4	kuti	200	Staples thumba 8/4
34	Letër formati A3	rizma	20	Letër fotokopje A3 80gr/m2. Pako me 500 fije. Te jete cilesi e pare. Te kete kualitet ne printim.
35	Prehëse lapsash	copë	50	Prehese lapsash e thjeshte
36	Libër Magazine	copë	30	Liber Magazine i thjeshte (200 fletesh)
37	Bllok urdher dorezimi	copë	100	Blloku të jetë me rubrika të ndara, të jetë me ngjitje, me kapak kartoni, format A6, me 2 kopje, minimumi të jetë me 100 flete pa kapakun.
38	Zarfa letre 11x23 cm	copë	250	Zarfa që shërbejnë si mjete të zakonshëm paketimi, të përbërë nga material i hollë dhe i sheshtë. Të shërbejnë për të mbajtur letra kartolina etj. Ngjyre e bardhe
39	Zarfa letre 16x23 cm	copë	250	Zarfa të bardhë me dimension 16x23 cm
40	Zarfa letre te medhenjë A4	copë	250	Zarfa letre te medhenj A4, me letër speciale, me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhe.
41	Marker nenvizimi	copë	50	Marker nënvizimi me ngjyra të ndryshme, majë min 1.2 mm
42	Etiketa per emertim dosjesh	copë	25	Etiketa ngjitëse 105x148 mm, pa diferencë. E pershtatshme për fotokopje, printer lazer etj. Format A4, min4 etiketat për fletë me ngjitje. Ngjyre e bardhe.
43	Lapsa	copë	200	Lapsa te thjeshte me gome

FLETË UDHËTIMI NR. _____

Tiranë, më _____
Për muajin _____

Automjeti Tip _____ targa _____ me lëndë djegëse _____

Hanëtimi karburantit për 100 km: _____ litra

Data	Nisja	Mbërrita	Lloji i mallit	Volumi nëS	Peshë Ton	Distanca km	K. zgjedhje ore punë	Ton/100	Nëratërimi i Personit Përgjegjës
SHUMA									

Sasia e karburantit të tërhequr _____ litra
Sasia e km të realizuara _____

Drejtuesi i Automjetit _____ Ekonomisti _____

Artikulli nr.18 flete udhetimi



Artikulli nr. 27 Dosje personeli

LËVRIMI I MALLIT

- Të gjithë artikujt do të sillen brënda **25 ditëve** pas lidhjes së kontratës në magazinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë, ku do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për marrjen në dorëzim të këtyre artikujve.
- Mallrat do të sillen pranë DPPGJ me mjetet e kontraktuesit.

NR	Emërtimi	Njësia	Sasia	Afati i levrimit	Vendi i dorezimit
1	Libër Protokolli 400 fletë	copë	20	25 dite	DPPGJ
2	Libër Poste	copë	20	25 dite	DPPGJ
3	Regjistër themeltar	copë	10	25 dite	DPPGJ
4	Dosje me mekanizëm	copë	500	25 dite	DPPGJ
5	Dosje plastike me ngjitese	copë	200	25 dite	DPPGJ
6	Qese A4 100 flete	pako	500	25 dite	DPPGJ
7	Staples” 24/6 + 23/13	kuti	200	25 dite	DPPGJ
8	Kapëse aktesh	kuti	200	25 dite	DPPGJ
9	Stick”,ngjitës 36gr	copë	50	25 dite	DPPGJ
10	Stilolapsa blu	copë	1000	25 dite	DPPGJ
11	Stilolapsa të kuq	copë	10	25 dite	DPPGJ
12	Bojë vule	copë	10	25 dite	DPPGJ

13	Mbajtëse vule	copë	5	25 dite	DPPGJ
14	Letër formati A4 80g/m2	Rizma	1999	25 dite	DPPGJ
15	Makinë kapëse aktesh 23/13	copë	5	25 dite	DPPGJ
16	Gomë fshirëse	copë	50	25 dite	DPPGJ
17	Kapëse aktesh nr. 5	kuti	200	25 dite	DPPGJ
18	Fletë-udhëtimi	bllok	200	25 dite	DPPGJ
19	Staple	copë	200	25 dite	DPPGJ
20	Gërshërë	copë	20	25 dite	DPPGJ
21	Makinë llogaritëse profesionale	copë	10	25 dite	DPPGJ
22	Mbajtëse kancelarie	copë	30	25 dite	DPPGJ
23	Korrektor	copë	100	25 dite	DPPGJ
24	Evidenciator	copë	100	25 dite	DPPGJ
25	Heqëse kapsesh	copë	200	25 dite	DPPGJ
26	Blloqe të vogla me ngjyra të ndryshme	copë	600	25 dite	DPPGJ
27	Dosje Personeli	copë	700	25 dite	DPPGJ
28	Dosje me qese	copë	50	25 dite	DPPGJ
29	Kalendar	copë	10	25 dite	DPPGJ
30	Blinder clips” me madhësi të ndryshme 32,18	copë	1000	25 dite	DPPGJ
31	Bllok axhende	copë	80	25 dite	DPPGJ
32	Vinovil 1000 ml	copë	20	25 dite	DPPGJ
33	“Staples” 8/4	kuti	200	25 dite	DPPGJ
34	Letër formati A3	rizma	20	25 dite	DPPGJ
35	Prehëse lapsash	copë	50	25 dite	DPPGJ
36	Libër Magazine	copë	30	25 dite	DPPGJ
37	Bllok urdher dorezimi	copë	100	25 dite	DPPGJ
38	Zarfa letre 11x23 cm	copë	250	25 dite	DPPGJ
39	Zarfa letre 16x23 cm	copë	250	25 dite	DPPGJ
40	Zarfa letre te medhenjë A4	copë	250	25 dite	DPPGJ
41	Marker nenvizimi	copë	50	25 dite	DPPGJ
42	Etiketa per emertim dosjesh	copë	25	25 dite	DPPGJ
43	Lapsa	copë	200	25 dite	DPPGJ

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punes i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

Gjithashtu NJP është bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve të vecanta teknike, grupi i ngritur me urdhër të titullarit të **AK Nr. 309 Prot, date 20.05.2024.**

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën perkatese të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Listat e Çmimeve të artikujve sipas, Shtojcës 2;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, sasia e kërkuar e mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2021,2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023)

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së.*

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 309 date 20.05.2024 specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të **paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 19% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët,

nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetohet se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001-2015 ose ekuivalente**.

Certifikata kërket të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e cilësisë të përcaktuar është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti, me qëllim transportin e mallit objekt kontrate, të cilin duhet t’a ketë në pronësi ose me qira/huapërdorje.

- Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë duhet të paraqiten:

a. *Certifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor.*

b. *Leje qarkullimi të vlefshme.*

c. *Certifikatë e kontrollit teknik.*

d. *Policë për sigurimin e detyrueshem (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga një prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.*

- Për mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje, përvec dokumentacioni të sipërcituar operatori ekonomik duhet të te disponojë kontratat noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 5/ ç, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjete për kryerjen e transportit të mallrave për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së,

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:*

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa

konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës, ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikes 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjes së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher te Titullarit te AK Nr. 309, date 20.05.2024, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Afati i shërbimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor per 15 ditë nga data e lidhjes se kontrates.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

